



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 4044 Prot

Vlorë, më 20.12.2018

VENDIM

Nr 49, datë 20.12.2018

**PËR SISTEMIMIN E FËMIJËS B. V NË QENDRËN E ZHVILLIMIT P.A.K VLORË**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 20.12.2018, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të VKM nr.425, datë 27.6.2012. “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale , publike dhe jopublike , të përkujdesjes shoqërore” (Ndryshuar me VKM nr.839, datë 3.12.2014; nr.106, datë 15.2.2017), të Ligjit Nr.10 347 datë 04.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijës”, Udhëzimit Nr. 6 datë. 21.05.2014 “Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublike”, ligjit 9355, datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe Shërbimin shoqëror” i ndryshuar, Udhëzimin nr.1730, datë 27.09.2010 “ Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore” kërkesës me nr.2823 prot dt.23/10.2018 të Bashkisë Selenicë, hyrë në Këshillin e Qarkut Vlorë, me nr. 3460 prot. datë 26/10/2018.

VENDOSI;

1. Fëmija B.V, të sistemohet në institucionin: Qendrën e Zhvillimit PAK, Vlorë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, Bashkia Selenicë dhe Qendra e Zhvillimit P.A.K Vlorë.

Sekretari i Këshillit të Qarkut  
Vllasi NASAJ

Jurist  
Alma MYRTAJ

Specialiste  
Anila HITAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të nderuar Këshilltarë!

Në lidhje me fëmijën me aftësi ndryshe B. V ju bëj me dije se është e datëlindjes 12/10/2007, familja përbëhet nga 6 persona dhe janë në një gjendje shumë të keqe ekonomike. Fëmija ka shfaqur shenja agresiviteti ndaj bashkëmoshatarëve, nuk i bindej asnjë këshillë, dhe këto kanë ndodhur duke filluar prej vitit 2015 nga ku ka filluar edhe procedura për rehabilitimin e fëmijës për tek Qendra e Zhvillimit PAK, Vlorë.

Fëmija e lindur në 2007 është e diagnostikuar me prapambetje të zhvillimit Mendor në bazë të " Fletë Drejtimi për KMCAP" me nr. 3 Regj, datë 22.10.2015, lëshuar nga Spitali Psikiatrik " Ali Mihali" Vlorë. Kërkesa vjen bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Selenicë (Vendimi nr. 71, datë 22.10.2018 " Për sisteminimin e Fëmijës në Qendrën Rezidenciale për Personat me Aftësi të Kufizuar Vlorë).

Është familje nevojtare, shumë e varfër dhe me probleme sociale.

Këtë situatë e konfirmon edhe punonjësja e NJMF-së Bashkia Selenicë, Orjeta Mishtaku .

Duke patur në fokus të punës tonë interesin më të lartë të fëmijëve dhe të ndodhur para këtyre fakteve, kërkojmë nga Ju miratimin e kësaj kërkesë.

*Mbetemi në pritje të vendimmarrjes Suaj!*

Specialiste:

Anila Hitaj

Juriste

Alma Myrtaj